



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opshtine/Mayor's Office

Nr. 02/98

Datë: 8 / 4 / 2020

Në mbështetje nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes 01 Nr. 06/1636, të datës: 03.09.2008, konform nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 20/2016), në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/07, të datës: 11.03.2020, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

URDHËRESË

- Me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, dhe në funksion të mbrojtjes së jetës së qytetarëve për ndërmarrjen e masave si në vijim:
 - OBLIGOHEN të gjitha ndërmarrjet publike dhe private, si dhe bizneset të ndërmarrin masa për mbrojtje dhe dezinfektim të objekteve në hyrje, brenda hapësirave dhe ambienteve ku po veprojnë dhe operojnë, të cilat kanë të bëjnë me masat e përforcuara higjienike.
 - Të gjithë dyqanet e shitjes së produkteve ushqimore në komunën e Shtimes, që në baza të rregullta gjatë ditës të dezinfektojnë, të gjitha karrocet dhe shportat që shërbejnë për bartjen e produkteve ushqimore dhe të njëjtën duhet ta dëshmojnë me raporte përkatëse të kompanive të dezinfektimit.
 - Obligohen të gjithë dyqanet e shitjes së produkteve ushqimore në komunën e Shtimes që të caktojnë një person përgjegjës i cili do të merret me respektimin e distancës së klientëve gjatë blerjes së produkteve ushqimore.
 - Mos respektimi i rekomandimeve do të ndëshkohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- OBLIGOHET Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Institucionet tjera relevante për zbatimin e kësaj urdhërese.
- Urdhëresa hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga ana e Kryetarit të Komunës.

T'i dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Inspektoratit Komunal
- Ndërmarrjeve Private
- Bizneseve
- Arkivit të Komunës

